

**Shtojca 12.**

*[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË  
AFATET E ANKIMIMIT**

**Data:** 04.11.2024

**Drejtuar:** “SHANSI INVEST” SHPK, me NUIS: J61924002T, me adresë: Tiranë, Tiranë, Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7.

**Operatorit Ekonomik (OE)**  ose

“SHANSI INVEST” SHPK, me NUIS: J61924002T, me adresë: Tiranë, Tiranë, Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7.

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)**

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO**  **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: \_\_\_\_\_

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës: **“Procedurë e hapur, Punë”**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **“Rehabilitimi i shkarkuesit katastrofik të rezervuarit të digës Karroq”**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-22915-10-04-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rehabilitimi i shkarkuesit katastrofik të rezervuarit të digës Karroq”, Fondi limit: 22 364 393 (njëzet e dy milion e tre qind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tre qind e nëntëdhjetë e tre ) lekë pa TVSH, Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 180 ( një qind e tetëdhjetë) ditë**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **07.10.2024**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike [Data] [Numri]: **Nr.69 datë 14 tetor 2024**

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1.“ ASI-2A CO” SHPK**

**K53002402C**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera: **20 000 001 (njëzet million e një) (lekë pa TVSH.**

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO • JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

**2.“ OUEN” SHPK**

**K175292150**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera: **22 099 234,5 (njëzet e dy million e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dy qind e tridhjetë e katër presje pesë) lekë pa TVSH.**

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO • JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

**3.“ SHANSI INVEST” SHPK**

**J61924002T**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera: **21 085 764 ( njëzet e një million e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatë qind e gjashtëdhjetë e katër ) lekë pa TVSH.**

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO • JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. “ ASI-2A CO” SHPK**

**K53002402C**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

**Vlera: 20 000 001 (njëzet million e një) (lekë pa TVSH.**

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO • JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**Për arsyet e mëposhtme:** Për arsyet e mëposhtme: Oferta e paraqitur nga “ASI-2A CO” SHPK, me NUIS: K53002402C , me vlerë 20 000 001 (njëzet million e një) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, sepse: Operatori ekonomik “ASI-2A CO” SHPK nuk plotëson kriterin 2.4.4 Operatori ekonomik në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës të publikuar në DST, për listen e artikujve, si me poshtë:

b. Waterstop tip RT 2000

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje Bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

2. Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listen e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shenim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. Dëshmi të testimeve zyrtare të kryera dhe të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve (sipas listes së mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

4. Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të certifikuar me ISO 9001 dhe / ose të pajisur me Çertifikatë Konformiteti CE dhe çertifikate origjine nga shtetet e Bashkimit Europian.

Operatori ekonomik ka paraqitur autorizimi nga Hongrui Boya (Tianjin) Trading Co., Ltd., autorizim I cili nuk është conform kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit sepse nuk përmban të dhënat e plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Po në të njëjtën kohë autorizimi dhe materialet bashkëlidhur nuk janë përkthyer nga nje perkthyes i licencuar dhe i vertetuar nga noteri “Vertetim perkthimi” dhe “Njesi me origjinalin”

## 2.“ OUEN” SHPK

**K175292150**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera: **22 099 234,5 (njëzet e dy million e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dy qind e tridhjetë e katër presje pesë) lekë pa TVSH.**

*(e shprehur në shifra dhe fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO • JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Për arsyet e mëposhtme: Oferta e paraqitur nga “OUEN” SHPK, me NUIS: K175292150 , me vlerë 22 099 234,5 (njëzet e dy million e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dy qind e tridhjetë e katër presje pesë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, sepse:

Operatori ekonomik “OUEN” SHPK nuk plotëson kriterin 2.4.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL), për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë dokumentacionin si me poshte:

- Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Liçencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”.
- Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Liçencimit (QKL) Kodi III.2.A për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Operatori ekonomik nuk ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Operatori ekonomik “OUEN” SHPK nuk plotëson kriterin 2.4.4 Operatori ekonomik në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkates të publikuar në DST, për listen e artikujve, si me poshtë:

a. Hekur

## b. Waterstop tip RT 2000

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

1. Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje Bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhena të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

2. Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listen e mësipërme të artikujve në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shenim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. Dëshmi të testimeve zyrtare të kryera dhe të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve (sipas listës së mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

4. Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 dhe / ose të pajisur me Çertifikatë Konformiteti CE dhe çertifikate origjine nga shtetet e Bashkimit Europian.

Operatori ekonomik nuk ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Operatori ekonomik "OUEN" SHPK nuk plotëson kriterin 2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Grejder (mjet teknologjik me goma) 1 cope Në pronesi ose me qera

Autobetoniere 1 cope Në pronesi ose me qera

Autopompe 1 cope Në pronesi ose me qera

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mësipërme, mjete të cilat i ka deklaruar në Formularin e vetëdeklarimit por që janë pa targa. Referuar nenit 47 "Klasifikimi i mjeteve rrugore" pika 1, e ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, parashikohet: 1. "Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod", klasifikohen si vijon:

### k) mjete teknologjike

Në nenin 58, pika 1 dhe 2, parashikohet: 1. "Mjetet teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë". 2. "Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, mjetet teknologjike ndahen në: a) mjete që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut"

Ndërsa në nenin 113 pika 2 e këtij ligji parashikohet: "Për të qarkulluar në rrugë mjetet teknologjike me goma, duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit". Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 "Për

Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave (Neni 113 i Kodit Rrugor)”, pika 1, parashikohet: “Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen pranë degës së DRShTRr-se rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës të atij që deklarohet pronar i mjetit.”

Referuar pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku citohet: AK kërkon mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën” si dhe bazuar në percaktimet ligjore të ligjit Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Njesia e Prokurimit është shprehur qartazi në kërkesat e DST për llojin e mjetit që kërkon, në mënyrë që plotësimi i kësaj pike të mos jetë konfuze për OE. (Referuar Vendimit 225/2023 të KPP).

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“SHANSI INVEST” SHPK, me NUIS: J61924002T, me adresë: Tiranë, Tiranë, Rruga “Reshit Çollaku”, Pallati 4, Shkalla 8, Apartamenti 7**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **21 085 764 ( njëzet e një milion e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatë qind e gjashtëdhjetë e katër ) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_]** është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.